



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Junikut
Opština Junik – Municipality of Junik




KONTRATA

Titulli i tenderit: Furnizim me klima për QKMF- në, Dr. "Ali Hoxha"

Numri i prokurimit: 636-20-4158-1-3-6

Numri i brendshëm: 636-20-016-136

Data: 14.10.2020



Komuna e Junikut (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), e përfaqësuar nga U.D. Zyrtaria Përgjegjëse e Prokurimit, Florinda Kukalaj në njërën anë,

dhe As Tech sh.p.k, (në vazhdim "Kontraktuesi"), me numër të regjistrimit të biznesit 810849200 dhe me numër fiskal 601262611, me adrese Prishtinë, Kosovë, me numër kontaktues: 044-770-161 dhe email: shpk.astech@gmail.com e përfaqësuar nga Afrim Sadiki në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara më poshtë:

Numri i prokurimit	636	2	0	4	1	5	8	1	3	6
Numri i brendshëm	636	2	0	0	1	6	1	3	6	

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës do të jetë Furnizim me klima për objektin e QKMF- së
- 1.2 Kontrata hynë në fuqi me 14.10.2020 dhe përfundon me 14.11.2020.
- 1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë nga data e marrjes së urdhëreses.
- 1.4 Vendi i kryerjes së furnizimeve do të jetë QKMF, Dr. "Ali Hoxha", dhe Administrata e Komunës.
- 1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: 2,130.00€; Dymijë e njëqind e tridhjetë euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të furnizimeve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të realizojë ndonjë ose të gjitha furnizimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Pejë, Dega- Deçan në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik- As Tech sh.p.k

Për Autoritetin Kontraktues- Komuna Junik

Emri:	Afrim Sadiki	Emri:	Florinda Kukalaj
Pozita:	Drejtore	Pozita:	U.D. Zyrtare Përgjegjëse e Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	14.10.2020	Data:	14.10.2020
Vula:		Vula:	

Aneksi 1.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Titulli i projektit: Furnizim me klima për QKMF

Historiku i problemit - Gjendja aktuale. Në mungesë të klimatizimit kushtet për punë janë të pa favorshme si pasojë e temperaturave të larta në sezonin e verës.

Përshkrimi i shkurtër teknik. Projekti parasheh Furnizimin sjelljen dhe montimin e klimave si në vijim:

1. 2 aparaturave klimatizuese nëpër të gjithë objektin e QKMF- së duke logaritur edhe gypat dhe stabilimentet deri tek valvulat, si dhe valvulat e përforcuara në muret e jashtme. Aparaturat klimatizuese duhet të kenë këto veçori: kapacitetet ftohëse 18000 Btu/h, kapacitetet ngrohëse 19000 Btu/h, Volumi i ajrit të filtruar 650m³/h, Frekuencat e përafërta 50 Hz dhe shkalla e zhurmës 43 dB (A). Si dhe
2. 6 aparaturave klimatizuese nëpër të gjithë objektin e QKMF- së dhe një në administratën komunale duke llogaritur edhe gypat dhe stabilimentet deri tek valvulat, si dhe valvulat e përforcuara në muret e jashtme. Aparaturat klimatizuese duhet të kenë këto veçori: kapacitetet ftohëse 12000 Btu/h, kapacitetet ngrohëse 13000 Btu/h.

Kondicioner 18 000 BTU		
Specifikimi Teknik		
Energjia Elektrike	Ph - V - Hz	220-240V ~ 50Hz, 1Ph
Ftohje		
Kapaciteti	Btu/h	18000 (5100-22000)
Hyrje	W	1640 (380-2300)
Korenti	A	7.2 (1.8-10.2)
EER	W/W	3.21
Ngrohje		
Kapaciteti	Btu/h	18500 (5300-23000)
Hyrje	W	1500 (350-2000)
Korenti	A	6.6 (1.6-9.0)
COP	W/W	3.61
Qarkullimi i ajrit brenda (Hi/Mi/Lo)	m ³ /h	600/480/400

B18 DOSJA E TENDERIT PËR Procedurën e -Kuotimit të Çmimit

10 / 20



Niveli i zhurmes brenda (Hi/Mi/Lo)	dB(A)	45/42/38
Hyrja Qendrore		
Dimensioni (W*D*H)	mm	930*198*275
Paketimi (W*D*H)	mm	1015*265*350
Pesha Neto	kg	10 / 13.5
Dalja e ajrit	m ³ /h	2200
Niveli i zhurmes jashte	dB(A)	54
Njesia e Jashtme		
Dimensioni (W*D*H)	mm	760*285*590
Paketimi (W*D*H)	mm	887*355*645
Pesha Neto	kg	37.5 / 39
Lloji antipiretik	g	R410A / 1180g
Antipiretik i Mprehte		
Gazi	mm (inch)	ø6.35 / ø12.7 (1/4" / 1/2")
Gjatësia e tubit antipiretik	m	20
Diferenca e nivelit	m	8
Temperatura		
Ngrohje/Ftohje (e brendshme)	°C	17 - 30
Ngrohje/Ftohje (e jashtme)	°C	0 - 50 / -15 - 34

Kondicioner 12 000 BTU		
Specifikimi Teknik		
Energjia Elektrike	Ph - V - Hz	220-240V ~ 50Hz, 1Ph
Ftohje		
Kapaciteti	Btu/h	12000
Hyrje	W	1095
Korenti	A	4.9
EER	W/W	3.21
Ngrohje		
Kapaciteti	Btu/h	12500
Hyrje	W	1015
Korenti	A	4.5
COP	W/W	3.32
Qarkullimi i ajrit brenda (Hi/Mi/Lo)	m ³ /h	600/500/400
Niveli i zhurmes brenda (Hi/Mi/Lo)	dB(A)	41/38/35
Hyrja Qendrore		
Dimensioni (W*D*H)	mm	790*196*275
Paketimi (W*D*H)	mm	865*265*350
Pesha Neto	kg	8 / 10
Dalja e ajrit	m ³ /h	1800
Niveli i zhurmes jashte	dB(A)	54

B18 DOSJA E TENDERIT PËR Proceduren e -Kuotimit të Çmimit



11 / 20

PARAMASA PER FURINIZIM ME KLIMA PER OBJEKTIN E

QKMFPARAMASA PER FURINIZIM ME KLIMA PER OBJEKTIN E QKMF

Njësia e Jashtme		
Dimensioni (W*D*H)	mm	780*250*540
Paketimi (W*D*H)	mm	910*355*585
Pesha Neto	kg	26 / 28
Lloji antipiretik	g	R410A / 760g
Antipiretik i Mprehte		
Gazi	mm (inch)	ø6.35 / ø12.7 (1/4" / 1/2")
Gjatësia e tubit antipiretik	m	20
Diferenca e nivelit	m	8
Temperatura		
Ngrohje/Ftohje (e brendshme)	°C	17 - 30
Ngrohje/Ftohje (e jashtme)	°C	0 - 50 / -15 - 34

Operatori Ekonomik i pranon specifikimet e ANEKSIT I duke i nënshkruar dhe vulosur si në vijim:

Emri i Operatorit Ekonomik: AS TECH SH.P.K

Nënshkrimi:

Vula:



PARAMASA PER FURINIZIM ME KLIMA PER OBJEKTIN E QKMF- së

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Shuma totale me TVSH
1	Furnizimi dhe montimi i klimave për QKMF 1800W	copë	2.00	345.00	690.00
2	Furnizimi dhe montimi i klimave për QKMF 1200W	copë	6.00	240.00	1,440.00
				TOTALI	2,130.00